<p>sistemeve fqinje, me të cilët është i ndërlidhur sistemi i transmisionit, me qëllim të arritjes së operimit të sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve të interkonektuara;</p> <p>1.41. të alokojë kapacitetet ndërkufitare transmetuese, në bashkëpunim me operatorët e sistemeve të transmisioneve të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, sipas procedurave të përbashkëta regjionale për kalkulimin dhe alokimin e kapaciteteve, të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;</p> <p>1.42. menaxhimi i kongestionit, për të gjitha transaksionet në interkonektorët me sistemet fqinje, në bazë të rregullave dhe mekanizmeve të tregut, të cilët përcaktohen dhe zbatohen së bashku me operatorët tjerë në tregun rajonalë të energjisë elektrike;</p> <p>1.43. dispeçimi i prodhimit dhe shfrytëzimi i interkonektorëve bëhet në bazë të kriterëve të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji që duhet të jenë objektive, të bëhen publike dhe të aplikohen në mënyrë jodiskriminuese në</p>	<p>neighbouring system operators, with which the transmission system is connected, with the view of ensuring safe and efficient operation, coordinated development and interaction of interconnected systems;</p> <p>1.41. allocating cross-border transmission capacities, in cooperation with transmission system operators from Parties of the Energy Community, in line with regionally joint procedures for calculation and allocation of proposed capacities by Transmission System Operators concerned and approved by the Energy Regulatory Office;</p> <p>1.42. congestion management for all transactions in interconnection lines with neighbouring systems, based on market rules and mechanisms, which are determined and implemented commonly with other operators in the regional electricity market;</p> <p>1.43. dispatching of generation and use of interconnection lines is conducted based on criteria approved by the Energy Regulatory Office which shall be objective, public and applied in a non-discriminatory manner, in order to enable the proper functioning of the</p>	<p>susednih sistema, sa kojima je povezan prenosni sistem, u cilju postizanja sigurnog i efikasnog operiranja, koordiniranog razvoja i interakcije inter-konekcijskih sistema;</p> <p>1.41. dodeljivanje prekograničnih prenosnih kapaciteta u saradnji sa operaterima prenosnih sistema ugovornih strana Energetske zajednice u skladu sa zajedničkim regionalnim procedurama za obračun i raspodelu kapaciteta predloženih od strane Operatora prenosnog sistema i usvojen od strane Regulatorne kancelarije za energiju;</p> <p>1.42. upravljanje uskih grla za sve transakcije u interkonekciji sa susednim sistemima, na osnovu pravila i tržišnih mehanizama, koji se definišu i sprovode zajedno sa ostalim operatorima na regionalnom tržištu električne energije;</p> <p>1.43. otprema proizvodnje i korišćenje inter-konektora vrši se na osnovu kriterijuma usvojenih od Regulatorne Kancelarije za Energiju, koji bi trebalo da bude objektivni, objavljeni i primenjeni na ne-diskriminatorni način, kako bi</p>
--	--	---

<p>mënyrë që të mundësojnë funksionim të përshtatshëm të tregut të energjisë elektrike. Kriteret duhet të marrin parasysh përparësitë ekonomike të njëjësive prodhuese në dispozicion, transferet ndërkufitare si dhe kufizimet teknike në sistem;</p> <p>1.44. dhënia e prioritetit dispeçimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit, me kusht që të mos bie ndesh me kufizimet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit dhe rregullat e rregulloret tjera për sigurinë e sistemit;</p> <p>1.45. kryerja e të gjitha veprimtarive tjera të parapara me këtë ligj dhe me ligjet tjera të zbatueshme;</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të bëj barazimin përfundimtar të aktivizimit të enegjisë balancuese me palët që kanë ofruar shërbime ndihmëse dhe palët përgjegjëse për jobalanc që kanë shkaktuar jobalanc.</p> <p>3. Operatori i Sistemit të Transmisionit duhet të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për operimin e sigurtë, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të transmisionit;</p>	<p>electricity market. The criteria shall take into account the economic advantages of available generation units, cross-border transfers and technical limitations in the system;</p> <p>1.44. giving priority to dispatch of electricity generation from renewable energy resources and co-generation, provided that it doesn't contradict the limits specified by the Grid Code and other rules and regulations on system security;</p> <p>1.45. carrying out other actions envisaged in this law and other applicable laws;</p> <p>2. The Transmission System Operator shall settle activated volumes of balancing energy with balancing service providers and all determined imbalances with balance responsible parties.</p> <p>3. The Transmission System Operator shall have available all necessary human, technical, physical and financial sources for safe, reliable and long-term operation of the transmission system;</p>	<p>omogućili odgovarajuće funkcionisanje tržišta električne energije. Kriterijumi će uzeti u obzir ekonomske prednosti proizvodnih jedinica na raspolaganju, preko-granične transfere i tehnička ograničenja u sistemu;</p> <p>1.44. davanje prioriteta otpremi proizvodnje električne energije iz obnovljivih izvora energije i ko-proizvodnje, pod uslovom da nisu u suprotnosti sa ograničenjima utvrđenim u Mrežni kodeks i drugim pravilima i propisima za bezbednost sistema;</p> <p>1.45. obavljanje svih drugih delatnosti predviđenih ovim zakonom i drugim primenjivim zakonima;</p> <p>2. Operator Prenosnog Sistema poravnjava aktivne napone balansne energije sa pružaocima balansnih usluga i sve utvrđene disbalanse sa balansno odgovornim stranama.</p> <p>3. Operater Prenosnog Sistema treba da ima na raspolaganje sve potrebne ljudske, tehničke, fizičke i finansijske resurse za sigurno, pouzdano i dugoročno operiranje prenosnog sistema;</p>
--	--	--

<p>4. Operatori i Sistemit të Transmisionit i raporton Zyrës së Rregullatorit për Energji, siç përcaktohet në licencën e tij sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe i ofron asaj informata mbi të gjitha çështjet që mund të kërkojnë, në formën dhe në intervalet e parapara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.</p>	<p>4. The Transmission System Operator shall report to the Energy Regulatory Office, as provided in its license and the Law on the Energy Regulator, and provide it with information on such matters it may specify, in such form and at such intervals as may be required by the Energy Regulatory Office.</p>	<p>4. Operater Prenosnog Sistema izveštava Regulatornoj kancelariji za energiju, kako je utvrđeno u njegovoj licenci, shodno Zakonu o energetskom regulatoru i pruža joj informacije o svim pitanjima koja se mogu tražiti, u formi i intervalima predviđenim od Regulatorne kancelarije za energiju.</p>
<p>5. Operatori i Sistemit të Transmisionit ofron informata të nevojshme njëjësive të qeverisjes lokale për qëllime të planifikimit të tyre të zhvillimit, duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave të përdoruesve individual të rrjetit.</p>	<p>5. The Transmission System Operator shall provide necessary information to local governance units, for their developing purpose of energy development planning, while respecting the confidentiality of data of individual network users.</p>	<p>5. Operater Prenosnog Sistema pruža potrebne informacije jedinicama lokalne samouprave u cilju njihove planiranja razvoja, poštujući poverljivost podataka individualnih korisnika mreže.</p>
<p>6. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për zbatimin e Kodit të Rrjetit dhe raportin, në baza vjetore, tek Zyra e Rregullatorit për Energji.</p>	<p>6. The Transmission System Operator shall be responsible for the implementation of the Grid Code and shall report annually to the Energy Regulatory Office.</p>	<p>6. Operater Prenosnog Sistema je odgovoran za implementaciju Kodeksa mreže i izveštava, na godišnjoj osnovi, kod Regulatorne Kancelarije za Energiju.</p>
<p>7. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për lejimin dhe menaxhimin e qasjes/shkyçjes së palës së tretë, duke përfshirë inkasimin e pagesave që i detyrohen palët për kyçje dhe qasje në rrjetin e transmisionit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.</p>	<p>7. The Transmission System Operator is responsible for allowing and managing access/disconnection of third parties, including collection of payments owed to it by parties for connection and access in the transmission network, in a non-discriminatory and transparent way.</p>	<p>7. Operater Prenosnog Sistema je odgovoran za odobravanje i upravljanje pristupa/isključenja treće stranke, uključujući i naplate koje duguju stranke za priključenje i pristup na prenosnu mrežu na transparentan i ne-diskriminatoran način.</p>
<p>8. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për mbledhjen e taksave dhe pagesave të kongestionit, në kuadër mekanizmit të kompensimit të operatorëve të sistemit inter-OST.</p>	<p>8. The Transmission System Operator shall be responsible for collecting congestion rents and payments under the inter-TSO system operator compensation mechanism</p>	<p>8. Operater prenosnog sistema je odgovoran za ubranje taksi i uplata konekcije u okviru mehanizma nadoknade operatera inter-OPS</p>

<p>9. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për pagesat sipas kontratave të lidhura, për shërbimet tjera të siguruara, përfshirë edhe shpenzimet e ndërlidhura me pjesëmarrjen e tij në organizata ndërkombëtare, pjesëmarrje kjo që buron nga detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian.</p>	<p>9. The Transmission System Operator is responsible for payments for executed contracts, other services provided, including expenses related to its participation in international organizations, which may be mandated through international agreements and European Union legislation.</p>	<p>9. Operater Prenosnog Sistema je odgovoran za uplate prema zaključenim ugovorima, za druge obezbeđene usluge, uključujući i troškove povezane sa njegovom učešće u međunarodne organizacije, učešće koje izvire iz obaveza prema međunarodnim sporazumima i zakonodavstvom Evropske Unije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Kodi i rrjetit</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Grid Code</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Kodeks mreže</p>
<p>1. Operimi dhe menaxhimi i rrjetit të transmisionit do të udhëhiqet nga Kodi i Rrjetit.</p> <p>2. Kodi i Rrjetit përcakton:</p> <p>2.1. kushtet teknike dhe kërkesa të tjera të cilave duhet t'iu përmbahen përdoruesit e lidhur në rrjetin e transmisionit;</p> <p>2.2. kushtet teknike dhe kërkesa tjera për transmission të sigurt të energjisë elektrike nga gjeneruesit dhe sistemet tjera dhe operim të sigurt të sistemit të transmisionit për furnizim të besueshëm dhe cilësor të energjisë elektrike tek konsumatorët fundorë;</p> <p>2.3. kushtet teknike për qasje në rrjet të transmisionit;</p>	<p>1. Operation and management of the transmission network shall be governed by Grid Code.</p> <p>2. Grid Code determines:</p> <p>2.1. Technical and other requirements for the user connected to the transmission network;</p> <p>2.2. Technical and other requirements for the safe transmission of electricity from generators and other systems and the safe operation of the transmission system for required reliable and quality of supply of final customers of electricity;</p> <p>2.3. technical requirements for network access to transmission network;</p>	<p>1. Operiranj e i upravljanje prenosne mreže rukovodiće se od Kodeksa mreže.</p> <p>2. Kodeks mreže setovi :</p> <p>2.1. tehničke i ostale uslove kojih se treba pridržavati priključeni korisnici na prenosnu mrežu,</p> <p>2.2. tehničke i ostale uslove za siguran prenos električne energije od proizvođača i drugih sistema i sigurno operiranje prenosnog sistema za pouzdano i kvalitetno snabdevanje električnom energijom kod krajnjih potrošača,</p> <p>2.3. tehničke uslove za pristup na prenosnu mrežu,</p>

<p>2.4. kushtet teknike për mirëmbajtje të rrjetit të transmisionit;</p> <p>2.5. përgjegjësitë teknike të përdoruesve të rrjetit të transmisionit;</p> <p>2.6. planifikimin operativ dhe menaxhimin e sistemit të transmisionit;</p> <p>2.7. procedurat për operimin e sistemit të energjisë elektrike në kushte të operimit normal dhe fuqisë madhore, rrjeteve të çrregulluara, rrjeteve të jashtëzakonshme apo rrethanave tjera të jashtëzakonshme;</p> <p>2.8. zonat e mbrojtura dhe kushtet e veçanta brenda fushës së mbrojtur të stabilimenteve elektrike;</p> <p>2.9. llojet dhe ofrimin e shërbimeve dhe sistemeve ndihmëse;</p> <p>2.10. kushtet teknike dhe kushtet tjera për interkoneksion dhe operim të rrjeteve;</p> <p>2.11. planifikimin zhvillimor të rrjeteve të transmisionit;</p> <p>2.12. dizajnin teknik dhe kërkesat operative për kyçe në sistem që do të sigurojë bashkëveprimin e sistemeve dhe do të jenë objektive dhe jodiskriminuese.</p>	<p>2.4.technical requirements for the maintenance of the transmission network;</p> <p>2.5.technical responsibilities of the transmission network users;</p> <p>2.6.operational planning and management of the transmission system;</p> <p>2.7.procedures of operation of the electricity system in normal network operation and in case of force majeure, disturbed networks, extraordinary network or other extraordinary circumstances;</p> <p>2.8.protected area and special conditions within the protected area of power facilities;</p> <p>2.9.types and provision of ancillary and systems services;</p> <p>2.10. technical and other conditions for interconnection and operation of the networks;</p> <p>2.11. development planning of transmission network;</p> <p>2.12. technical design and operational requirements for connection to the system that shall ensure the interoperability of systems and shall be objective and non-</p>	<p>2.4. tehničke uslove za održavanje transmisione mreže;</p> <p>2.5. tehničke odgovornosti korisnika prenosne mreže,</p> <p>2.6. operativno planiranje i upravljanje prenosnog sistema,</p> <p>2.7. procedure operiranja elektroenergetskog sistema u uslovima normalnog operiranja i više sile, poremećenih mreža vanrednih mreža ili vanrednih okolnosti,</p> <p>2.8. zaštićene zone i posebne uslove unutar zaštićene zone električnih postrojenja,</p> <p>2.9. vrste i pružanje pomoćnih usluga i sistema,</p> <p>2.10. tehničke i druge uslove za interkonekciju i operiranje mreža,</p> <p>2.11. razvojno planiranje prenosnih mreža;</p> <p>2.13. tehnički dizajn i operativni zahtevi za priključenje na sistem osiguravaju razmenu funkcija i podataka između sistema i objektivni su i nediskriminatorni</p>
--	---	---

<p>3. Operatori i Sistemit të Transmisionit zhvillon Kodin e Rrjetit ndërsa Zyra e Rregullatorit për Energji miraton atë. Gjatë zhvillimit të Kodit të Rrjetit, Operatori i Sistemit të Transmisionit obligohet që të sigurojë pjesëmarrje adekuate të të gjitha palëve me interes dhe të organizojë dëgjime publike për së paku pesëmbdhjetë (15) ditë. Kodi i rrjetit duhet të publikohet në faqen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Kodi i Matjes</p> <p>1. Instalimi, operimi dhe menaxhimi i sistemit të matjes në kufij të rrjetit të transmisionit kryhet në bazë të Kodit të Matjes.</p> <p>2. Kodi i Matjes përcakton:</p> <p>2.1. karakteristikat e pajisjeve matëse në pikat matëse të përdoruesve të rrjetit;</p> <p>2.2. tiparet e pajisjeve matëse apo standardeve që duhet të plotësohen nga pajisjet matëse për të mundësuar menaxhimin e kërkesës dhe matjen e konsumit të energjisë elektrike në intervale kohore;</p>	<p>discriminatory.</p> <p>3. Transmission System Operator develops and proposes Grid Code and Energy Regulatory Office approves. During development of The Grid Code Transmission System Operator is obliged to provide adequate participation of all stakeholders and organize a public hearing for at least fifteen (15) days. Grid Code shall be published in Transmission System Operator web page.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Metering Code</p> <p>1. Installation, Operation and management of the metering system in boundary of transmission network governed by Metering Code.</p> <p>2. Metering Code determines:</p> <p>2.1. characteristics of metering equipment at the metering point of network users;</p> <p>2.2. properties of the measuring equipment or standards to be met by measuring equipment to enable demand management and time interval metering of electricity consumption;</p>	<p>3. Operater Prenosnog Sistema razvija Kodeks mreže, dok Regulatorna Kancelarija za Energiju usvaja isti. Tokom razvoja Kodeksa mreže, Operater prenosnog sistema je obavezan da obezbedi učešće svih zainteresovanih strana i da organizovati javne debate za najmanje petnaest (15) dana. Kodeks mreže treba da bude objavljen na veb-stranici Operatera prenosnog sistema.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Kodeks merenja</p> <p>1. Instalacija, operiranje i upravljanje mernog sistema u granicama prenosne mreže sprovedena na osnovu Kodeksa merenja.</p> <p>2. Kodeks merenja određuje:</p> <p>2.1. karakteristike merne opreme u mernim tačkama korisnika mreže;</p> <p>2.2. karakteristike merne opreme i standarde koji se moraju ispuniti od merne opreme kako bi se omogućilo upravljanje potražnje i merenje potrošnje električne energije u vremenskim intervalima,</p>
---	--	--

<p>2.3. tiparet e pajisjeve matëse apo standardeve që duhet të plotësohen nga pajisjet në pikat e matjes që përdoruesit duhet t'i përmbushë, kushtet funksionale, saktësinë e pajisjeve matëse dhe metodat për matjen e energjisë elektrike në sistemin e transmissioinit, në veçanti në kuptim të:</p> <p>2.3.1. metodës së instalimit, pranimit, testimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve matëse;</p> <p>2.3.2. metodës së grumbullimit, të leximit të njehsorëve dhe të dhënave tjera në pikat matëse, dhe</p> <p>2.3.3. qasshmërisë, përpunimit të të dhënave dhe bartjes së leximeve nga njehsorët dhe të dhënave tjera tek përdoruesit e të dhënave, si dhe grumbullimi dhe arkivimi i të dhënave.</p> <p>2.4. përcaktimit të standardeve teknike dhe zgjidhjeve për instalimin e sistemeve matëse për përdoruesit e rrjetit.</p> <p>3. Operatori i Sistemit të Transmissioinit zhvillon ndërsa Zyra e Rregullatorit për Energji miraton Kodin e Matjes. Gjatë zhvillimit të Kodit të Matjes, Operatori i Sistemit të Transmissioinit obligohet që të sigurojë pjesëmarrje adekuate të të gjithë akterëve dhe të organizojë dëgjime publike</p>	<p>2.3. properties of the measuring equipment or standards of measuring equipment at the metering point the user should meet, functional requirements, accuracy of measuring devices and method of measurement of electricity in transmission system , particularly with regard to :</p> <p>2.3.1. installation method, acceptance, testing and maintenance of measuring equipment;</p> <p>2.3.2. collection method, meter readings and other data at the measuring point and</p> <p>2.3.3. accessibility, data processing and transfer of meter readings and other data to data users , as well as the collection and archiving of data.</p> <p>2.4. determination technical standard and solutions for installation of metering systems of network users.</p> <p>3. Transmission System Operator develops and proposes and Energy Regulatory Office approves Metering Code. During development of the Metering Code, Transmission System Operator is obliged to provide adequate participation of all stakeholders and organize a public hearing for</p>	<p>2.3. karakteristike merne opreme ili standarda koji se moraju ispuniti od opreme u mernim tačkama koje mora ispuniti korisnik, funkcionalne uslove, tačnost merne opreme i metode za merenje električne energije u prenosni sistem, posebno u pogledu:</p> <p>2.3.1. metoda instaliranja, prihvatanja, testiranja i održavanja merne opreme,</p> <p>2.3.2. metoda prikupljanja, očitavanja brojila i drugih podataka mernih tačaka, i</p> <p>2.3.3. dostupnost, obradu podataka i prenos učitavanja brojila i drugih podataka kod korisnika podataka, kao i prikupljanje i arhiviranje podataka.</p> <p>2.4. u postavljanju tehničkih standarda i rešenja za ugradnju mernih sistema za korisnike mreže.</p> <p>3. Operater Prenosnog Sistema razvija, dok Regulatorna kancelarija za energiju usvaja Kodeks merenja. Tokom razvoja Kodeksa mreže, Operater prenosnog sistema je obavezan da obezbedi odgovarajuće učešće svih aktera i da organizovat javne debate za najmanje 15 (petnaest) dana. Kodeks merenje</p>
---	--	---

<p>për së paku pesëmbdhjetë (15) ditë. Kodi i Matjes publikohet në ueb-faqen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Prokurimi i Energjisë Elektrike dhe kapaciteteve nga Operatori i Sistemit të Transmisionit</p> <p>1. Operatori i Sistemit të Transmisionit mund të angazhohet në prokurimin e energjisë dhe kapacitetit, bazuar në procedura transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg vetëm për qëllimet në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. humbjet e rrjetit të transmisionit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. balancimin e sistemit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. ofrimi i shërbimeve ndihmëse sipas procedurës transparente, jodiskriminuese dhe të bazuar në treg.</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmisionit, energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmisionit duhet ta blejë në tregun e energjisë elektrike. Nëse i ofron evidencën për çdo rast individual tek Zyra e Rregullatorit për Energji duke provuar se një blerje e tillë fizikisht nuk është e mundur, Zyra e Rregullatorit për Energji mund të kërkojë nga prodhuesit që të ofrojnë energjinë elektrike të kërkuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e</p>	<p>at least 15(fifteen) days. Metering Code shall be published in Transmission System Operator web page.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Procurement of Electricity and capacities from the Transmission System Operator</p> <p>1.The Transmission System Operator may engage in electricity and capacity procurement according to transparent, non-discriminatory and market-based procedure only for the following purposes:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. transmission network losses;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. system balancing;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. provision of ancillary services according to transparent, non-discriminatory and market-based procedure.</p> <p>2. The Transmission System Operator shall purchase energy required for covering losses in the transmission network in the electricity market. If it provides evidence for each individual case to the Energy Regulatory Office that such purchases are physically not possible, the Energy Regulatory Office may demand from producers to offer the electricity required for covering transmission network losses. The Energy Regulatory Office, based</p>	<p>treba da bude objavljen na veb-stranici Operatera Prenosnog Sistema.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Javna nabavka električne energije i kapaciteta od Operatera Prenosnog Sistema</p> <p>1.Operater Prenosnog Sistema može biti angažovan u javnoj nabavci energije i kapaciteta, bazirajući se na transparente, nediskriminatorne procedure, bazirane na tržište, samo u sledeće svrhe:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. gubitaka prenosne mreže;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. balansiranje sistema;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. pružanje dodatnih usluga u skladu sa transparentnim, nediskriminatornim i na tržištu zasnovanim postupkom.</p> <p>2.Operater Prenosnog Sistema, energiju za pokrivanje gubitaka u prenosnoj mreži treba kupiti na tržište električne energije. Ukoliko pruža evidenciju za svaki pojedinačni slučaj kod Regulatorna Kancelarija za Energiju , dokazujući da takva kupovina nije fizički moguća, Regulatorna Kancelarija za Energiju može tražiti od proizvođača da pružaju traženu električnu energiju za pokrivanje gubitaka u prenosnoj mreži.</p>
--	--	---

<p>transmisionit. Zyra e Rregullatorit për Energji, në bazë të raporteve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, prodhuesit dhe subjektet e tjera, të zbatojnë obligimet e shërbimit publik të siguruar mbulimin e humbjeve në transmision.</p> <p>3. Operatori i Sistemit të Transmisionit siguron shërbimet e sistemit në përputhje me parimet e tregut dhe të kontratave për ofrimin e shërbimeve. Shfrytëzimi i shërbimeve të ofruara nga ofruesi i shërbimeve ndihmëse dhe shërbimeve balancuese mund të bëhet me kërkesë të Operatorit të Sistemit të Transmisionit.</p> <p>4. Rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë të gjitha rregullat për koston e jobalancimit nga shfrytëzuesit e sistemit. Të gjitha këto rregulla duhet të jenë pjesë e Rregullave të Tregut dhe duhet të dorëzohen për miratim nga Operatori i Sistemit të Transmisionit në Zyrën e Rregullatorit për Energji. Termat dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të tilla nga Operatori i Sistemit të Transmetimit do të përcaktohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe duhet të jenë jodiskriminuese dhe me kosto reflektuese dhe</p>	<p>on reports of the Transmission System Operator, may require the Transmission System Operator, generators and other entities to implement public service obligations to ensure that transmission losses are covered.</p> <p>3. The Transmission System Operator ensures system services in compliance with market principles and service provision contracts. At the request of the Transmission System Operator, services provided by ancillary service and balancing service providers may be utilized.</p> <p>4. Rules for electricity system balancing shall be objective, transparent and non-discriminatory, including all rules on imbalance costs for system users. All such rules shall be part of Market Rules and shall be submitted for approval to the Energy Regulatory Office by the Transmission System Operator. The terms and conditions, including the rules and tariffs for the provision of such services by the Transmission System Operator shall be established pursuant to a methodology approved by the Energy Regulatory Office in a non-discriminatory and cost-reflective way and shall be published.</p>	<p>Regulatorna kancelarija za energetiku, na osnovu izveštaja Operatora prenosnog sistema, može zahtevati od Operatora prenosnog sistema, proizvođača i drugih subjekata, sprovodi obaveze javne usluge u cilju obezbeđivanja pokrivenosti gubitaka u prenosu.</p> <p>3. Operator Prenosnog Sistema obezbeđuje usluge sistema u skladu sa tržišnim načelima i ugovorima o pružanju usluga. Usluge koje pruža pružalac pomoćnih i usluga balansiranja mogu se koristiti na zahtev operatora prenosnog sistema.</p> <p>4. Pravila za balansiranje elektroenergetskog sistema moraju biti objektivna, transparentna i ne-diskriminatorna, uključujući sva pravila za troškove ne-balansiranja od korisnika sistema. Sva ova pravila moraju biti deo tržišnih pravila i treba da se dostave za usvajanje od strane Operator Prenosnog Sistema u Regulatornoj Kancelariji za Energiju. Termini i uslovi, uključujući pravila i tarife za obezbeđivanje takvih usluga od Operatera Prenosnog Sistema, utvrdiće se na osnovu metodologije usvojene od Regulatorne Kancelarije za Energiju i moraju biti ne-diskriminatorne i odražavati troškove i moraju se publikovati.</p>
---	--	--

duhet të publikohen.

Neni 17
Informatat konfidenciale

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit duhet të ruajë informatat konfidenciale tek të cilat vjen gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta. Publikimi apo zbulimi i informacioneve nga Operatori i Sistemit të Transmisionit lidhur me veprimtarinë e tij që mund t'i sjell përparësi ose përfitim ndonjë personi tjetër, kryhet në mënyrë jodiskriminuese.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria përgjegjëse për energji apo Zyra e Rregullatorit për Energji mund të kërkojnë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit informacione konfidenciale të domosdoshme për t'i zbatuar funksionet, autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre

Neni 18
Promovimi i bashkëpunimit rajonal

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit përfaqëson Kosovën në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit të Energjisë Elektrike.

2. Operatori i Sistemit të Transmisionit, me

Article 17
Confidential information

1. The Transmission System Operator shall maintain confidential information obtained in the course of performing its activities. Publication or other disclosure by the Transmission System Operator of any information about its activities which may bring advantages or benefits to any other person conducted in a non-discriminatory manner.

2. Notwithstanding paragraph 1 of this article, the Ministry responsible for energy, or the Energy Regulatory Office may require the Transmission System Operator to provide the any confidential information necessary to implement their functions, powers, duties and responsibilities.

Article 18
Promotion of Regional Cooperation

1. The Transmission System Operator represents Kosovo in the European Network of Transmission System Operators of Electricity.

2. The Transmission System Operator, with

Član 17
Poverljive informacije

1. Operater prenosnog sistema mora sačuvati poverljive informacije do kojih dolazi tokom obavljanja svojih aktivnosti. Objavljanje ili otkrivanje informacija od strane Operatera prenosnog sistema vezano za njegovu aktivnost koje može doneti prednost ili korist nekoj drugoj osobi, obavlja na ne-diskriminatorni način.

2. Izuzetno od stava 1 ovog člana, nadležno Ministarstvo za energetiku može tražiti od Operatera Prenosnog Sistema poverljive informacije neophodne za sprovođenje njihovih funkcija, ovlašćenja, obaveza i odgovornosti.

Član 18
Promovisanje regionalne saradnje

1. Operater Prenosnog Sistema predstavlja Kosovo u Evropskoj mreži operatera prenosnih sistema električne energije.

2. Operater Prenosnog Sistema, uz prethodnu

<p>pëlqimin paraprak të Zyrës së Rregullatorit për Energji, merr pjesë në operimin e një ose më shumë sistemeve të integruara në kuadër të një ose më shumë rajoneve të cilat mbulohen nga një ose më shumë palë të Komunitetit të Energjisë me qëllim të alokimit të kapaciteteve transmetuese dhe verifikimit të sigurisë operative dhe me qëllim të themelimit dhe zhvillimit të tregjeve rajonale të energjisë elektrike dhe liberalizimin e tyre.</p>	<p>prior consent of the Energy Regulatory Office, takes part in the operation of one or more integrated systems within one or more regions that are covered by one or more Parties to the Energy Community, with the aim of allocating transmission capacities and verifying operational security and with the aim of establishing and developing regional electricity markets and their liberalization.</p>	<p>saglasnost Regulatorne kancelarije za energiju, učestvuje u radu jednog ili više sistema, integriranih u okviru jednog ili više regiona koji se pokrivaju od jedne ili više stranaka Energetske zajednice, sa ciljem alokacije prenosnih kapaciteta i proveravanja radne bezbednosti, te u cilju osnivanja i razvoja regionalnih tržišta električne energije i njihove liberalizacije.</p>
<p>3. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të promovojë marrëveshjet operative në mënyrë që të sigurohet menaxhim optimal të rrjetit të Komunitetit të Energjisë dhe do të nxisë zhvillimin e shkëmbimeve të energjisë, ndarjen e koordinuar të kapacitetit ndërkuftar përmes gjetjes së alternativave jodiskriminuese të bazuara në treg, duke i kushtuar vëmendje meritore të veçantë ankandeve implicite për alokimet afatshkurtra, dhe integrimin e mekanizmave të balancimit dhe kapacitetit rezervë.</p>	<p>3. The Transmission System Operator shall promote operational arrangements in order to ensure the optimum management of the Energy Community network and shall promote the development of energy exchanges, the coordinated allocation of cross-border capacity through non-discriminatory market-based solutions, paying due attention to the specific merits of implicit auctions for short-term allocations, and the integration of balancing and reserve power mechanism.</p>	<p>3. Operater Prenosnog Sistema će promovisati operativne sporazume kako bi se obezbedilo optimalno upravljanje mreže Energetske Zajednice i podstakao razvoj razmene električne energije, koordiniranu podelu preko-graničnog kapaciteta kroz iznalaženje ne-diskriminatornih alternativa baziranih na tržište, posebno obraćajući zasluženu pažnju implicitnim aukcijama za kratkoročna izdvajanja i integraciju mehanizama balansiranja i rezervnom kapacitetu.</p>
<p>4. Operatori i Sistemit të Transmisionit merr parasysh opinionet, rekomandimet dhe zbaton vendimet e institucioneve të krijuara në Komunitetin e Energjisë, apo në Bashkimin Evropian, në rastet kur këto organizata janë të mandatuara, nga marrëveshjet apo rregulloret ndërkombëtare të obligueshme për Kosovën.</p>	<p>4. Transmission System Operator shall take into account the opinions, recommendations and shall implement the decisions of institutions established in the Energy Community, or the European Union, where such organizations are mandated by regulations or international agreements binding on Kosovo;</p>	<p>4. Operater Prenosnog Sistema uzima u obzir mišljenja, preporuke i sprovodi odluke institucija formiranih u Energetskoj Zajednici, ili Evropskoj Zajednici, u slučajevima kada su ove organizacije mandatirane iz međunarodnih sporazuma ili pravilnika, obaveznih za Kosovo.</p>
<p>5. Operatori i Sistemit të Transmisionit</p>	<p>5. The Transmission System Operator</p>	<p>5. Operater Prenosnog Sistema saraduje sa</p>

bashkëpunon me organizata nga paragrafi 4 i këtij neni për sigurimin e informatave të domosdoshme lidhur me planet zhvillimore të rrjetit, përdorimit dhe zhvillimit të interkonektorëve dhe bashkëpunimit rajonal.

KAPITULL IV ORGANIZIMI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 19 Tregu i energjisë elektrike

1. Tregu i energjisë elektrike përfshinë tregjet e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë.
2. Shitëblerja në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë kontraktohet nëpërmjet kontratave bilaterale dhe nëpërmjet tregut të organizuar të energjisë elektrike.
3. Tregu bilateral i energjisë elektrike është tregu ku blerja dhe shitja e energjisë elektrike realizohet drejtpërdrejtë ndërmjet pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike në bazë të marrëveshjes bilaterale për shitëblerjen e energjisë elektrike.
4. Tregtimi i energjisë elektrike në kuadër të tregut të energjisë bëhet lirshëm dhe në bazë të interesave ekonomike të secilit pjesëmarrës.

cooperates with organizations as per paragraph 4 of this Article in ensuring the necessary information regarding network development plans, use and development of interconnection lines and regional cooperation.

CHAPTER IV ORGANIZATION OF THE ELECTRICITY MARKET

Article 19 Electricity Market

1. The electricity market includes wholesale and retail electricity markets.
2. Wholesale and retail sale and purchase of electricity is contracted through bilateral contracts or through the organized electricity market.
3. The bilateral electricity market is the market in which electricity sale and purchase is conducted directly between electricity market participants, based on bilateral electricity sale and purchase agreements.
4. Trading of electricity in frame of the electricity market is done freely and based on economic interests of each participant.

organizacijama iz stava 4 ovog člana za obezbeđivanje neophodnih informacija u vezi sa razvojnim planovima mreže, korišćenjem i razvojem inter-konekcija i regionalne saradnje.

POGLAVLJE IV ORGANIZACIJA TRŽIŠTA ELEKTRIČNE ENERGIJE

Član 19 Tržište električne energije

1. Tržište električne energije obuhvata tržišta električne energije na veliko i malo.
2. Kupoprodaja na tržištu električne energije na veliko i malo ugovara se kroz bilateralne ugovore i kroz organizovano tržište električne energije.
3. Bilateralno tržište električne energije je tržište gde se kupovina i prodaja električne energije realizuje direktno preko učesnika na tržištu električne energije na osnovu bilateralnog sporazuma o kupoprodaji električne energije.
4. Trgovanje električne energije u okviru tržišta električne energije radi se slobodno i na osnovu ekonomskih interesa svakog učesnika.

<p>5. Ndërmarrjet e enegjisë e të cilat janë në pronësi publike dhe ato ndermarrje që ofrojnë sherbime publike, tregtimin me energjinë elektrike të nevojshme për realizimin e obligimeve dhe të drejtave licencore, përkatësisht shitjen apo blerjen e energjisë elektrike, e bëjnë në pajtim me Procedurat për tregtimin e energjisë elektrike të cilat propozohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit të cilat miratohen dhe publikohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Për të siguruar efikasitetin e kostos dhe çmimin më të lirë të mundshëm, duke pasur parasysh specifikat e tregut të energjisë elektrike, këto procedura nuk i nënshtrohen kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik.</p>	<p>5. Publicly owned Electricity undertakings and those enterprises that provide public services, trade electricity needed for disbursement of their licensory duties and responsibilities, respectively sell or buy electricity, based on Procedures for trade of electricity which are proposed by the Transmission System Operator and approved and published by the Energy Regulatory Office. In order to ensure efficiency of costs and cheapest price possible, takin into account specificities of the electricity market, these procedures are not subject to requirements of the Law on Public Procurment.</p>	<p>5. Energetska preduzeća koja su u javnom vlasništvu i ona preduzeća koja pružaju javne usluge , trgovanje električnom energijom potrebnom za ostvarivanje prava i obaveza licenciranja , odnosno prodaju ili kupovinu električne energije, rade u skladu sa procedurama za trgovanje električne energije koji se predlažu od strane operatora prenosnog sistema , koja su usvajaju i objavljuju od strane Regulatorne kancelarije za energetiku . Da bi se osigurala efikasnost troškova i najnižu moguću cenu , uzimajući u obzir specifičnosti tržišta električne energije , ovi postupci ne podležu se zahtevima Zakona o javnim nabavkama.</p>
<p>6. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për miratimin një ditë para të programeve të shitëblerjeve të energjisë elektrike të palëve brenda Republikës së Kosovës dhe programeve ndërkufiatre, në bazë të obligimeve kontraktuale që rrjedhin nga shitëblerja në tregun e energjisë elektrike.</p>	<p>6. Transmission system Operator is responsible for day ahead validation of contractual electricity sale and purchase eschedules of parties inside Republic of Kosovo and cross border schedules, based on contractual obligations deriving from sales and purchases in the electricity market.</p>	<p>6.Operator prenosnog sistema je odgovoran za usvajanje dan pre nego što program predstavlja kupoprodaju električne energije stranaka u Republici Kosovo i međugraničnih programa, u skladu sa ugovornim obavezama koje proističu iz kupoprodaje u tržištu električne energije.</p>
<p>7. Operatori i Tregut dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit janë përgjegjës për organizimin e tregut një ditë para dhe atij ndërditor për tregtimin fizik të energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe për bashkimin e tij me tregjet tjera të energjisë elektrike. Mundësia e konstituimit të ankandeve të energjisë</p>	<p>7. The Market Operator and the Transmission System Operator are responsible for the organization of the day-ahead and intraday electricity market for physical trading of electricity in the entire territory of Republic of Kosovo, and for its coupling with other electricity markets. The possibility of constitution of a financial electricity auction</p>	<p>7. Operater Tržišta i Operater Prenosnog Sistema su odgovorni za organizovanje tržišta jedan dan pre i međudnevnog za fizičku trgovinu električne energije unutar teritorije Republike Kosova i za njegovo ujedinjenje sa drugim tržištima električne energije. Mogućnost konstituisanja aukcija električne energije neće se ograničiti od</p>

<p>elektrike nuk do të kufizohet nga Operatori i Tregut.</p> <p>8. Operatori i Sistemi të Transmisionit është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e tregut të balancimit të energjisë elektrike.</p> <p>9. Në tregun balancues të energjisë elektrike, Operatori i Sistemi të Transmisionit pranon ofertat për shitje dhe ofertat për blerje në tregun balancues për nevoja të balancimit të sistemit elektro energjetik, dhe për të garantuar sigurinë e punës së sistemit elektro energjetik, ndërmerr masa dhe i aktivizon ofertat për shitje dhe ofertat për blerje të energjisë elektrike për balancim, në bazë të një liste të ofertave sipas përparësisë ekonomike.</p> <p>10. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për llogaritjen e jobalancit të energjisë elektrike dhe çmimit të jobalancit, për çdo pjesëmarrës, për çdo periudë të barazimit përfundimtar dhe faturimin në përputhje me Rregullat e Tregut.</p> <p>11. Pjesëmarrja në tregun balancues të energjisë elektrike rregullohet me marrëveshje për ofrimin e shërbimit balancues të cilën Operatori i Sistemit të Transmisionit e përmbyllë me pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike. Marrëveshja e tillë përmban një pjesë të rregullave të tregut në</p>	<p>shall not be restricted by the Market Operator.</p> <p>8. Transmission System Operator is responsible for organization and development of the balancing electricity market.</p> <p>9. In the balancing electricity market, the Transmission System Operator receives bids and offers in the balancing market for purposes of electricity system balancing, in order to guarantee operational safety of the electricity system, undertakes measures and activates electricity bids and offers for balancing purposes, based on economic merit order list.</p> <p>10. Transmission System Operator is responsible for calculation of electricity imbalance and imbalance prices for each market participant for each specified settlement period and for billing, in compliance with Market Rules.</p> <p>11. Participation in the balancing electricity market is regulated through agreements on balancing service provision, which the Transmission System Operator executes with balancing service providers. Such agreements shall contain a part of market rules related to electricity balancing and final</p>	<p>Operatera Tržišta.</p> <p>8. Operator Prenosnog Sistema odgovoran je za organizaciju i razvoj balansnog tržišta električne energije</p> <p>9. Na balansnom tržištu električne energije, Operator Prenosnog Sistema prima ponude na balansnom tržištu za potrebe balansiranja sistema električne energije, kako bi se garantovao bezbedan rad elektroenergetskog sistema, i preduzima mere i aktivira ponude za balansne potrebe po redosledu ekonomske zasluge.</p> <p>10. Operator Prenosnog Sistema odgovoran je za obračun električnog disbalansa i cene disbalansa za svakog učesnika na tržištu za svaki utvrđeni period poravnjanja i za račune, u skladu sa tržišnim pravilima.</p> <p>11. Učešće na izbalansiranom tržištu električne energije uređuje se sporazumom za pružanje izbalansirane usluge, koju Operater Prenosnog Sistema zaključuje sa učesnicima na tržištu električne energije. Takav sporazum sadrži deo pravila tržišta u vezi sa balansiranjem električne energije i završno</p>
--	--	--

<p>lidhje me balancimin e energjisë elektrike dhe barazimin përfundimtar të energjisë balancuese.</p> <p>12. Operatori i Tregut bënë barazimin përfundimtar financiar për shërbimet e ofruara të balancimit.</p> <p>13. Operatori i Sistemit të Transmisionit njofton Zyrën e Rregullatorit për Energji për kontratat e përmbyllura për shërbimet balancuese me ofruesit e shërbimit të balancimit dhe për zbatimin mujor të kontratave të tilla pas kërkesës së Zyrës e Rregullatorit për Energji .</p>	<p>settlements of balancing energy.</p> <p>12. The Market Operator shall perform the final financial settlement of balancing services provided.</p> <p>13. The Transmission System Operator shall inform the Energy Regulatory Office on contracts on balancing services executed with balancing service providers and on the monthly implementation of such contracts, upon request of the Energy Regulatory Office.</p>	<p>izjednaçavanje izbalansirane energije.</p> <p>12. Operater Tržišta vrši završno izjednaçavanje za pružene usluge balansiranja.</p> <p>13. Operater Prenosnog Sistema t obaveštava Regulatornu Kancelariju za Energiju o zaključenim ugovorima za izbalansirane usluge sa pružaocima usluge balansiranja i za mesečno sprovođenje takvih ugovora nakon zahteva Regulatornu Kancelariju za Energiju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Operatori i Tregut</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Market Operator</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Operater tržišta</p>
<p>1. Operatori i Tregut përzgjidhet nga Qeveria përmes një procesi të hapur.</p> <p>2. Operatori i Tregut duhet të jetë i pavarur, në formën e saj juridike, marrëdhënieve pronësore, strukturave organizative dhe vendimmarrëse, nga të gjitha aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me transmisionin e energjisë elektrike.</p> <p>3. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Tregut personat përgjegjës për menaxhimin e tij nuk mund të marrin pjesë në struktura apo procese vendimmarrëse të Ministrisë, Zyrës së</p>	<p>1. The Government is responsible for selecting the Market Operator through an open process.</p> <p>2. The Market Operator shall be independent of all activities that do not relate to electricity transmission in its legal form, property relations, organizational and decision-making structures.</p> <p>3. In order to ensure the independence of the Market Operator, the persons responsible for its management may not participate in any structure or any decision-making process of</p>	<p>1. Operatera Tržišta bira Vlada preko otvorenog procesa.</p> <p>2. Operater Tržišta mora biti nezavisan, u pravnom smislu, imovinskim odnosima, organizacionim strukturama i odlučivanja, od svih aktivnosti koje se ne odnose na prenos električne energije.</p> <p>3. Za obezbeđivanje nezavisnosti Operatera tržišta odgovorna lica za njegovo upravljanje ne mogu učestvovati u strukture i procese odlučivanja Ministarstva, Regulatorne</p>

<p>standardeve minimale të përgjithshme dhe atyre të garantuara të cilësisë së garantuar të furnizimit me energji elektrike;</p> <p>2.5. mënyrën e rregullimit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në varësi nga metoda e përzgjedhur e rregullimit tarifor;</p> <p>2.6. vendosjen shkallë shkallë të kompenzimeve financiare të konsumatorit fundor, pas vendosjes së standardeve të cilësisë së garantuar të furnizimit me energji elektrike;</p> <p>2.7. mënyrën, dinamikën dhe fushën e informimit si dhe dorëzimin e të dhënave Zyrës së Rregullatorit për Energji mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike;</p> <p>2.8. përmbajtjen e raportit vjetor të Operatorit të Sistemit të Transmisionit mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike;</p> <p>2.9. përmbajtjen e raportit vjetor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike;</p> <p>2.10. përmbajtjen e raportit vjetor të furnizuesit mbi cilësinë e shërbimit të furnizimit.</p> <p>3. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe</p>	<p>general standards and guaranteed standards of electricity supply;</p> <p>2.5. manner of regulation of electricity supply quality, depending on the selected tariff regulation method;</p> <p>2.6. scaled determination of financial compensations for final customers, upon establishment of guaranteed quality of electricity supply,</p> <p>2.7. manner, dynamics and field of information, and submission of data on the quality of electricity supply to Energy Regulatory Office ;</p> <p>2.8. contents of the annual Transmission System Operator report on quality of electricity supply;</p> <p>2.9. contents of the annual Distribution System Operator report on quality of electricity supply;</p> <p>2.10. contents of the annual supplier report on the quality of supply services.</p> <p>3. The Transmission System Operator and</p>	<p>minimalnih standarda, opštih i zagaranovanih u odnosu na zagaranovani kvalitet snabdevanja električnom energijom;</p> <p>2.5. način regulisanja kvaliteta snabdevanja električnom energijom u zavisnosti od izabranog metoda i tarifnog regulisanja;</p> <p>2.6. uvođenje stepen po stepen finansijskih nadoknada krajnjem potrošaču nakon uspostavljanja standarda zagaranovano kvaliteta snabdevanja električnom energijom;</p> <p>2.7. način, dinamiku i oblast informisanja, kao i dostavljanje podataka Regulatornoj Kancelariji za Energiju o kvalitetu snabdevanja električnom energijom;</p> <p>2.8. sadržaj godišnjeg izveštaja Operatera Prenosnog Sistema o kvalitetu snabdevanja električnom energijom;</p> <p>2.9. sadržaj godišnjeg izveštaja Operatera Distributivnog Sistema o kvalitetu snabdevanja električnom energijom;</p> <p>2.10. sadržaj godišnjeg izveštaja snabdevanja o kvalitetu usluge snabdevanja.</p> <p>3. Operater Prenosnog Sistema i Operater</p>
---	--	---

<p>Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes obligohen që në pajtim me kushtet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike sistematikisht të:</p> <p>3.1. ruajnë shkallën e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;</p> <p>3.2. përcjellin treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike si; dhe</p> <p>3.3. udhëheqin me evidencën e të dhënave të nevojshme për vërtetimin e treguesve të cilësisë së energjisë elektrike.</p> <p>4. Secili furnizues obligohet që në pajtim me kushtet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike sistematikisht të:</p> <p>4.1. ruaj shkallën e cilësisë së shërbimit;</p> <p>4.2. përcjellë treguesit e cilësisë së shërbimit si; dhe</p> <p>4.3. mbajë evidencën e të dhënave të nevojshme për vërtetimin e cilësisë së shërbimit.</p> <p>5. Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe secili furnizues, një herë në vit duhet të publikojnë raportet për cilësinë e furnizimit me energji elektrike si dhe të raportojë dhe dorëzojë të dhëna në Zyrën e Rregullatorit për Energji në</p>	<p>Distribution System Operator are obliged to systematically, in compliance with conditions of the quality of electricity system:</p> <p>3.1. preserve the quality of electricity supply,</p> <p>3.2. follow-up on electricity supply quality indicators;</p> <p>3.3. maintain a registry of data necessary for verifying electricity supply quality indicators;</p> <p>4. All suppliers are obligated to systematically, and in compliance with conditions of electricity supply quality:</p> <p>4.1. preserve the level of service quality,</p> <p>4.2. follow-up on service quality indicators;</p> <p>4.3. maintain a registry of data necessary for verifying service quality.</p> <p>5. The Transmission System Operator, Distribution System Operator, and all suppliers, shall once per year publish reports on the quality of electricity supply and report and submit to Energy Regulatory Office all data related to the quality of electricity supply.</p>	<p>Distributivnog Sistema se obavezuju da, u skladu sa uslovima kvaliteta snabdevanja električnom energijom, sistematski:</p> <p>3.1. sačuvaju stepen kvaliteta snabdevanja električnom energijom;</p> <p>3.2. prate pokazatelje kvaliteta snabdevanja električnom energijom, kao i</p> <p>3.3. vode evidenciju potrebnih podataka za potvrđivanje pokazatelja kvaliteta električne energije.</p> <p>4. Svaki snabdevač se obavezuje da, u skladu sa uslovima kvaliteta snabdevanja električnom energijom, sistematski:</p> <p>4.1. sačuva stepen kvaliteta usluge;</p> <p>4.2. prati pokazatelje kvaliteta usluge, kao i</p> <p>4.3. vodi evidenciju potrebnih podataka za potvrđivanje kvaliteta usluge.</p> <p>5. Operater Prenosnog Sistema, Operater Distributivnog Sistema i svaki snabdevač, jednom godišnje, treba da objavljuju izveštaje o kvalitetu snabdevanja električnom energijom, kao i da izveštavaju i dostavljaju podatke Regulatornoj Kancelariji</p>
--	---	---

<p>lidhje me cilësinë e furnizimit me energji elektrike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Mbrojtja e konsumatorit</p> <p>1. Konsumatori fundor gëzon mbrojtjen e të drejtave të tij në pajtim me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra sipas këtij ligji, si dhe legjislacionin që rregullon mbrojtjen e konsumatorit.</p> <p>2. Ndalohen sjelljet e pahijshme dhe të padrejta dhe aktivitetet mashtruese në kuptimin e mbrojtjes së konsumatorit, derisa kushtet dhe afatet e ofruara për nënshkrim të kontratës të jenë transparente dhe të shkruara në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.</p> <p>3. Derisa kryen aktivitetet e punës së tij, furnizuesi duhet të veprojë në atë mënyrë që të sigurojë pozitë të barabartë të konsumatorëve të energjisë elektrike.</p> <p>4. Konsumatori ka të drejtë të:</p> <p>4.1. marrë të gjitha informatat e përcaktuara sipas këtij ligji;</p> <p>4.2. marrë njoftimin adekuat për synimin e modifikimit të kushteve të kontratës, si dhe informohen për të drejtën e tyre të</p>	<p style="text-align: center;">Article 45 Customer Protection</p> <p>1. Final customers shall be entitled to protect their rights in compliance with this law, sub-legal acts issued based on this law, and customer protection legislation.</p> <p>2. An improper and unfair behavior and/or fraudulent activities, in the sense of consumer protection, is prohibited, whereas conditions and terms offered for contract signing purposes shall be transparent and written in simple and comprehensible language.</p> <p>3. While performing its activities, the supplier shall act in a manner that ensures equal treatment of electricity customers.</p> <p>4. Customers:</p> <p>4.1. are entitled to receive all information stipulated under this law.</p> <p>4.2. receive adequate notifications on the intent to modify contract conditions, and are informed on their right to withdraw at</p>	<p>za Energiju u vezi sa kvalitetom snabdevanja električnom energijom.</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Zaštita potrošača</p> <p>1. Krajnji potrošač uživa zaštitu njegovih prava u skladu sa ovim zakonom, pod zakonskim aktima donetim shodno ovom zakonu, kao i zakonodavstva koje reguliše zaštitu potrošača.</p> <p>2. Zabranjuju se nedolična i nepravедna ponašanja i aktivnosti prevare u smislu zaštite potrošača, dok su uslovi i pruženi rokovi za potpisivanje ugovora transparentni i pisani u jasan i razumljiv jezik.</p> <p>3. Dok se obavljaju aktivnosti njegovog rada, snabdevač treba da postupa na način da osigurava ravnopravan položaj potrošača električne energije.</p> <p>4. Potrošač ima pravo da:</p> <p>4.1. dobija sve informacije utvrđene ovim zakonom;</p> <p>4.2. dobija odgovarajuće obaveštenje o teŕnji modifikacije uslova ugovora, kao i da bude informisan o njihovom pravu</p>
---	---	--

<p>tërheqjes kur jepet ai njoftim. Ofruesit e shërbimit i njoftojnë të abonuarit e tyre drejtpërdrejt për çfarëdo rritje në shpenzime, në kohën e përshtatshme jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pasi rritja ka hyrë në fuqi, në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Konsumatorët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata nëse nuk i pranojnë kushtet e reja që iu njoftohen atyre nga ofruesi i shërbimit të energjisë elektrike;</p> <p>4.3. pranojë informata transparente për çmimet dhe tarifatat e vlefshme dhe kushte e afatet standarde, në lidhje me qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;</p> <p>4.4. merr ofertën për një zgjedhje të gjerë të metodave të pagesës, të cilat nuk bëjnë diskriminim të paarsyeshëm mes konsumatorëve. Sistemi i parapagimit duhet të jetë i drejtë dhe të reflektojë në masë adekuate konsumin e mundshëm. Secili dallim në kushte e afate duhet të reflektojë shpenzimet e furnizuesit në sisteme të ndryshme të pagesës. Kushtet dhe afatet e përgjithshme duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato duhen ofruar në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme si dhe nuk do të përmbajnë barriera jokontraktuese ndaj ushtrimit të të drejtave të konsumatorit. Konsumatori duhet mbrojtur nga metodat e padrejta apo</p>	<p>the moment of such notice. Service provisions shall notify their subscribers directly on any increased expenses, at an appropriate time, but no later than the thirty (30) days following the entry into force of such increase, in a transparent and comprehensive manner. Customers are entitled to withdraw from the contract if they do not admit new conditions notified to them by the electricity service provider.</p> <p>4.3.receive transparent information on applicable prices and tariffs and standard terms and conditions, in relation to access to and use of electricity services.</p> <p>4.4.receive offers for a wide range of payment methods, which shall not unjustifiably discriminate customers. Prepayment systems shall be fair and adequately reflect possible consumption. Any difference in terms or conditions shall reflect supplier's expenses in various payment systems. General terms and conditions shall be fair and transparent. They shall be provided in a clear and comprehensible language and shall not contain any non-contractual barriers for the exercise of customer rights. Customers shall be protected from unfair or fraudulent sales methods.</p>	<p>povlačenja kada im se takvo obaveštenje daje. Pružaoci usluge će direktno obavestavati njihove pretplatnike o bilo kakvom povećanju troškova, u odgovarajućem vremenu, ne kasnije od trideset(30) dana nakon stupanja povećanja na snagu, na transparentan i sveobuhvatan način. Potrošači imaju pravo da se povuče iz ugovora ukoliko ne prihvataju nove uslove koji im se nude od pružaoca usluga električne energije;</p> <p>4.3. dobija transparentne informacije o važećim cenama i tarifama i standardnim uslovima i rokovima, u vezi sa pristupom i korišćenjem usluga električne energije;</p> <p>4.4. dobija ponudu za širi izbor metoda plaćanja, koja ne čine nerazumnu diskriminaciju između potrošača. Sistem pretplate mora biti pravedan i da odražava u odgovarajućoj meri moguću potrošnju. Svaka razlika u uslovima i rokovima treba da odražava troškove snabdevača u različite sisteme plaćanja. Opšti uslovi i rokovi moraju biti pravedni i transparentni. Moraju biti pruženi u jasan i razumljiv jezik i ne treba da sadrže ne-ugovorne barijere prema ostvarivanju prava potrošača. Potrošač mora biti zaštićen od nepravednih ili iskrivljujućih metoda prodaje</p>
---	---	--

<p>shtrembëruese të shitjes;</p> <p>4.5. nuk paguan për ndërrimin e furnizuesit;</p> <p>4.6. përfiton nga procedurat transparente, të thjeshta dhe jo të shtrenjta në trajtimin e ankesave të tyre. Në veçanti, të gjithë konsumatorët duhet të kenë të drejtë për një standard të mirë të shërbimit dhe trajtimit të ankesave nga ofruesi i shërbimeve të energjisë elektrike. Procedurat e tilla të zgjidhjes jashtëgjyqësore të kontesteve mundësojnë zgjidhje të mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, brenda tre (3) muajsh, me ofrimin, aty ku kërkohet, e një sistemi të rimbursimit ose kompensimit;</p> <p>4.7. kur kanë qasje në shërbimin universal, të jenë të informuar për të drejtat e tyre në lidhje me shërbimet universale;</p> <p>4.8. të kanë në dispozicion të dhënat e konsumit të tyre, si dhe duhet të jenë në gjendje, me pajtim të shprehur dhe pa pagesë, t'i ofrojnë ndërmarrjes së regjistruar të furnizimit qasje në të dhënat e njehsimit. Zyra e Rregullatorit për Energji definon formatin e të dhënave si dhe procedurën për furnizuesit dhe konsumatorët që të kenë qasje në të dhëna. Konsumatori nuk ngarkohet me shpenzime shtesë për atë shërbim;</p>	<p>4.5. shall not pay for changing their supplier;</p> <p>4.6. benefit from transparent, simple and inexpensive procedures for treatment of their appeals. Specifically, all customers shall be entitled to a good standard of service and treatment of appeals by electricity service providers. Such non-judicial dispute resolution procedures shall provide for a fair and prompt resolution of disagreements, preferably within three(3) months, with the provision, whenever required, of a system of reimbursement and/or compensation.</p> <p>4.7. shall be informed on their rights related to universal service, whenever they have access to universal services.</p> <p>4.8. shall have available data on their consumption and shall be able, with express consent and without charge, to offer the enterprise licensed for supply, access to metering data. Energy Regulatory Office shall define the format of data and procedures for both suppliers and customers to have access to data. Customers shall not be subject to additional expenses for such service;</p>	<p>4.5. ne plaća za promenu snabdevača;</p> <p>4.6. profitira od transparentnih, jednostavnih i ne skupih procedura u tretiranju njihovih žalbi. posebno, svi potrošači moraju da imaju pravo za dobar standard usluge i tretiranja žalbi od strane pružaoca usluga električne energije. Takve procedure van sudskog rešavanja sporova omogućavaju rešavanje nesporazuma na pravedan i brz način, u roku od tri(3) meseca, uz pružanje, tamo gde se zahteva, sistema nadoknade ili obeštećenja</p> <p>4.7. kada imaju pristupa u univerzalnoj usluzi, da budu informisani o njihovim pravima u vezi sa univerzalnim uslugama;</p> <p>4.8. imaju na raspolaganje podatke o njihovoj potrošnji, kao i moraju biti u stanju, u skladu uz izraženu želju i besplatno, da pružaju registrovanom preduzeću za snabdevanje pristup u svim podacima brojila. Regulatorna Kancelarija za Energiju utvrđuje format podataka, kao i proceduru za snabdevače i potrošače da imaju pristupa u takve podatke. Potrošač se ne tereti dodatnim troškovima za tu uslugu;</p>
---	---	---

<p>4.9. të informohet mirë për konsumin aktual të energjisë elektrike dhe shpenzimet aq shpesh sa t'i mundësohet atyre rregullimi i konsumit vetanak i energjisë elektrike. Ato informata ofrohen brenda një kornize kohore të mjaftueshme, e cila merr parasysh kapacitetin e pajisjeve matëse të konsumatorit dhe produktit elektrik në fjalë. Duhet të merret parasysh edhe efikasiteti në kosto i atyre masave. Konsumatori nuk ngarkohet me shpenzime shtesë për atë shërbim;</p> <p>4.10. merr llogarinë përfundimtare të mbylljes pas ndërrimit të furnizuesit të energjisë elektrike jo më vonë se gjashtë (6) javë pas kryerjes së ndërrimit të furnizuesit.</p> <p>5. Sisteme inteligjente të njehsimit që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e furnizimit me energji elektrike mund të vendoset duke pasur në konsideratë:</p> <p>5.1. zbatimin e sistemeve të tilla të njehsimit apo matjes që i nënshtrohet një vlerësimi ekonomik të të gjitha shpenzimeve dhe përfitimeve afatgjate për tregun dhe konsumatorin individual, apo të formës së matjes inteligjente që është ekonomikisht e arsyeshme dhe efektive në kosto, si dhe afatit që është i arsyeshëm</p>	<p>4.9. shall be timely informed on actual electricity consumption and expenditure, so as to be able to regulate its own electricity consumption. Such information shall be provided in a timely manner, taking into account the capacity of customer's metering devices and relevant electricity products. The cost-efficiency of such measures shall also be taken into account. Customers shall not be subject to any additional charges for such services;</p> <p>4.10. shall receive final closing accounts, after changing electricity suppliers, no later than six(6) weeks upon entry into effect of the supplier change.</p> <p>5. Intelligent metering systems, which enable customers' active participation in the electricity supply market, may be installed, with due consideration of the following:</p> <p>5.1. the implementation of such metering or measurement systems may be subject to an economic assessment of all its long-term expenses and benefits for the market and individual customers, as well as of the form of intelligent metering which is economically feasible and cost-effective, and the reasonable timeframe for their</p>	<p>4.9. da bude informisan o aktuelnoj potrošnji električne energije i troškovima toliko često, da im se omogući sređivanje sopstvene potrošnje električne energije. Te informacije pružaju se u okviru dovoljnog vremenskog roka, koji uzima u obzir kapacitet merne opreme potrošača i navedenog električnog produkta. Treba da se uzima u obzir i efikasnost u troškovima tih mera. Potrošač se ne tereti dodatnim troškovima za tu uslugu;</p> <p>4.10. dobija završni račun nakon promene snabdevača električne energije ne kasnije od šest (6) nedelja nakon obavljanja promene snabdevača.</p> <p>5. Inteligentni sistemi brojanja koji omogućuju aktivno učešće potrošača na tržištu snabdevanja električnom energijom mogu se ugraditi, imajući u obzir:</p> <p>5.1. implementacija takvih sistema brojanja ili merenja podleži ekonomskoj proceni svih troškova i dugoročnih profita za tržište i individualnog potrošača, ili oblika inteligentnog merenja koje je ekonomski opravdano i efektivno u troškovima, kao i rok koji je razuman za njihovu distribuciju. Takva procena će se</p>
--	--	--

<p>për shpërndarjen e tyre. Vlerësimi i tillë do të bëhet deri më 1 janar 2017. Sipas atij vlerësimi, Zyra e Rregullatorit për Energji përgatit një tabelë afatesh me cak deri në dhjetë (10) vjet për zbatimin e sistemeve inteligjente të matjes;</p> <p>5.2. nëse instalimi i njehsorëve inteligjentë vlerësohet pozitivisht, së paku 80% e konsumatorëve do të pajisen me sisteme inteligjente të matjes deri më 2022.</p> <p>6. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron ndërveprimin e atyre sistemeve të matjes për zbatimin në territorin e saj, si dhe të marrë parasysh shfrytëzimin e standardeve përkatëse dhe praktikave të mira, si dhe rëndësinë e zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike.</p> <p>7. Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të sigurojë ofrimin e një pike të vetme kontakti për t'i furnizuar konsumatorët me të gjitha informatat e nevojshme në dispozicion që lidhen me të drejtat e tyre, ligjin aktual dhe mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rast kontesti. Pika e tillë e kontaktit mund të jenë pjesë e pikave të informimit të përgjithshëm të konsumatorit.</p>	<p>distribution and installation. Such assessments shall be conducted no later than by 01 January 2017. In accordance with the said assessment, Energy Regulatory Office shall prepare a timeline matrix for the implementation of intelligent metering systems, with the deadline set at no longer than within ten(10) years.</p> <p>5.2. in the event that the installation of intelligent meters is positively assessed, at least 80% of customers shall be equipped with intelligent metering systems by 2022.</p> <p>6. Energy Regulatory Office shall ensure interaction between metering systems implemented in its territory, and, in this aspect, shall take into consideration the utilization of relevant standards and good practices, as well as the significance of internal electricity market development.</p> <p>7. Energy Regulatory Office shall ensure the provision of single points of contact to provide consumers with all necessary information concerning their rights, current legislation and the means of dispute settlement available to them in the event of dispute. Such contact point may be a part of general consumer information points.</p>	<p>izvršiti do 1. januara 2017. godine. prema toj proceni, Regulatorna Kancelarija za Energiju priprema tabelu rokova sa ciljem do deset (10) godina za implementaciju inteligentnih sistema merenja.</p> <p>5.2. ukoliko se ugrađivanje inteligentnih brojila pozitivnog procenjuje, najmanje 80% potrošača će biti opremljeni inteligentnim sistema merenja do 2022 godine.</p> <p>6. Regulatorna Kancelarija za Energiju obezbeđuje interakciju tih sistema merenja za implementaciju na njevoj teritoriji, kao i da uzima u obzir korišćenje odgovarajućih standarda i dobrih praksi kao i značaj razvoja unutrašnje tržišta električne energije.</p> <p>7. Regulatorna Kancelarija za energiju treba da osigurava pružanje jedne jedine kontakt tačke za snabdevanje potrošača svim raspoloživim potrebnim informacijama, koja se odnose na njihova prava, aktuelni zakon i način rešavanja nesporazuma u slučaju spora. Takve kontakt tačke mogu biti deo tačaka opšteg informisanja potrošača.</p>
---	---	---

<p>8. Një mekanizëm i pavarur siç është ombudsmani i energjisë ose organ për konsumatorin duhet të caktohet me qëllim të trajtimit efikas jashtë gjyqësor të kontesteve.</p>	<p>8. Independent mechanism such as an energy ombudsman or a consumer body shall be in place in order to ensure efficient treatment of complaints and out-of-court dispute settlements.</p>	<p>8. Nezavisan potrošač, kao što je ombudsman energije ili organ za potrošača mora da se određuje u cilju efikasnog tretiranja van sudskog rešavanja sporova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 46 Mbrojtja e konsumatorëve të cenueshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 46 Protection of vulnerable customers</p>	<p style="text-align: center;">Član 46 Zaštita privilegovanih potrošača</p>
<p>1. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe hisedarët tjerë në sektorin e energjisë elektrike, duhet të zhvillojë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve të cenueshëm, fushëveprimet të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike.</p>	<p>1. The Ministry in charge for social welfare shall develop, in cooperation with the Ministry in charge for energy, Ministry of Finance and in consultation with the Energy Regulatory Office and other stakeholders of the electricity sector, a detailed program for establishing the status of socially vulnerable customers, the scope of rights, as well as measures aimed at protecting the socially vulnerable customers in order to meet their electricity demand.</p>	<p>1. Ministarstvo zaduženo za socijalnu zaštitu dužno je da, u saradnji sa ministarstvom zaduženim za energetiku, Ministarstvom Finansija i u konsultaciji sa Energetskom Regulatornom Kancelarijom te drugim zainteresovanim stranama u sektoru električne energije, osmisli detaljan program za utvrđivanje statusa socijalno ugroženih potrošača, obim prava, kao i mere za zaštitu socijalno ugroženih potrošača, kako bi se zadovoljile njihove potrebe za električnu energiju.</p>
<p>2. Programi i trajtimit të konsumatorëve të cenueshëm i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të aprovohet nga Qeveria dhe do të përfshijë së paku një nga elementet në vijim:</p>	<p>2. The program of treatment of vulnerable customers referred to under paragraph 1 of this article shall be approved by the Government and shall include at least the following elements:</p>	<p>2. Program postupanja sa ugroženim potrošačima iz stava 1 ovog člana usvaja Vlada i isti obuhvata bar sledeće elemente:</p>
<p>2.1. caktimin e konsumatorëve të cenueshëm që përfitojnë nga programi i përcaktuar sipas këtij neni si:</p> <p>2.1.1. nuk do të përfshijë më shumë se një</p>	<p>2.1. definition of vulnerable customers benefiting from the above established program; defined in this article as:</p> <p>2.1.1. not include more than a</p>	<p>2.1. definicija privilegovanih potrošača koji koriste gore utvrđeni program, definicija ovog člana kao;</p> <p>2.1.1. obuhvata manjinski broj</p>

<p>pakicë të konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë;</p> <p>2.1.2. do të jetë i kufizuar në konsumatorët e energjisë elektrike me të ardhurat më të ulëta që përdorin energji elektrike për furnizim për banimin e përhershëm, ku për përcaktimin e të ardhurave të ulëta, përveç të ardhurave, do të merren parasysh të gjitha asetet në dispozicion;</p> <p>2.2. do t'i bëhet referencë nivelit maksimal i konsumit të energjisë elektrike për person duke pasqyruar sezonën, kur përcaktohet niveli i konsumit të energjisë elektrike për person, do të merret parasysh konsumi total deri në treqind (300) KWh për një familje me deri katër (4) anëtarë.</p> <p>2.3. mënyrën e mbështetjes së drejtpërdrejtë nga ana e Qeverisë për konsumatorët e cenueshëm nga burime të tjera të të ardhurave ndryshe nga tarifat që i ngarkohen të licencuarit, për të shmangur ndërshtetërishtet dhe shtrembërimin e çmimeve; dhe</p> <p>2.4. financimi për mbështetje për konsumatorët e cenueshëm duhet të realizohet në mënyrë jodiskriminuese dhe në veçanti nuk duhet të financohet nga konsumatorët e energjisë elektrike.</p>	<p>minority of electricity customers in Kosovo;</p> <p>2.1.2. be limited to natural gas customers with lowest income using electricity for supplying her/his permanent housing where for the definition of low income, beside the income, all available assets shall be taken into account;</p> <p>2.2. make reference to a maximum level electricity consumption per person reflecting seasonality; when defining electricity consumption level per person, total consumption of up to 300 KWh/month for a family with up to four (4) members shall be considered.</p> <p>2.3. manner of direct support by the Government to vulnerable customers from revenue sources other than tariff charges by licensees, to avoid cross subsidies and price distortion; and</p> <p>2.4. funding for support for vulnerable customers should be accomplished in a non-discriminatory manner, and in particular should not be funded from electricity customers.</p>	<p>potrošača električne energije na Kosovu;</p> <p>2.1.2. obuhvata samo potrošače električne energije sa niskim nivoom prihoda, a koji električnu energiju koriste za snabdevanje svog trajnog smeštaja gde definicija niskog nivoa prihoda, pored osnovnog prihoda, obuhvata i celokupnu aktivu;</p> <p>2.2. upućivanje na najviši nivo potrošnje električne energije po licu i po sezoni; za definisanje nivoa potrošnje električne energije po licu, računa se ukupna potrošnja od 300 KWh mesečno za porodicu sa najviše četiri (4) člana;</p> <p>2.3. Način neposredne podrške koju Vlada daje privilegovanim potrošačima iz izvora prihoda osim naplate taksi za licence, kako bi se izbegle preklapajuće subvencije i narušavanje cena; i</p> <p>2.4. Izdvajanje sredstava kako bi se podržali privilegovani potrošači vrši se bez diskriminacije, a posebno, ne sme se vršiti na teret potrošača gasa.</p>
--	---	--

<p>3.Konsumatorët shtëpiakë që përfitojnë nga mbështetja financiare për pagesat për shërbimin e furnizimit me energji elektrike nuk do të lejohen të shfrytëzojnë fondet e tilla për qëllime të tjera.</p> <p>4. Konsumatorët shtëpiakë që kanë marrë vendim mbi statusin e tyre të konsumatorëve të cenueshëm socialë kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në përputhje me këtë ligj dhe me programin e zhvilluar sipas paragrafit 1. të këtij neni.</p> <p>5. Konsumatorët e cenueshëm kanë të drejtë në shërbim të furnizimit sipas këtij neni për aq kohë sa janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, të cilat do të verifikohen të paktën çdo gjashtë (6) muaj nga autoriteti përgjegjës për mirëqenie sociale. Nëse, për shkak të ndryshimit të rrethanave, konsumatori humb statusin e konsumatorit të cenueshëm social, ai do të fshihet nga regjistri përkatës, por të dhënat e tij do të ruhen për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas regjistrimit të tij në regjistrin në fjalë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes njofton konsumatorin e cenueshëm dhe furnizuesin e tij, me shkrim dhe brenda tetë (8) ditëve, në lidhje me fshirjen e konsumatorit të cenueshëm nga regjistri përkatës.</p> <p>6. Ndryshimi ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave nga aktiviteti i furnizuesit për</p>	<p>3. Household customers benefiting from a financial support for payments for the electricity supply service shall not be allowed to use such funds for other purposes.</p> <p>4. Household customers who have obtained the decision on their socially vulnerable customer status shall have the right to special protection in accordance with this Law and the program developed under paragraph 1 of this Article.</p> <p>5.Vulnerable customers are entitled to a supply service pursuant to this Article as long as the conditions from the paragraph 1 of this Article are fulfilled, which shall be verified at least every six (6) months by the authority responsible for the social welfare. If, due to a change of circumstances a customer loses the socially vulnerable customer status he shall be deleted from the relevant register, but his data shall remain available for a period of five (5) years after his registration into the said register. The concerned Distribution System Operator shall, in writing and within eight (8) days, notify the vulnerable customer and his supplier regarding the deletion of said vulnerable customer from the concerned register.</p> <p>6. The difference between costs and revenues from the activity of a supplier for socially</p>	<p>3.Potrošači domaćinstva koji koriste finansijsku podršku za plaćanje usluge snabdevanja prirodnim gasom nemaju pravo da ista sredstva koriste u druge svrhe.</p> <p>4.Potrošači domaćinstva koja dobiju status privilegovanog potrošača imaju pravo na posebnu zaštitu u skladu sa ovim Zakonom i programom iz stava 1. ovog člana.</p> <p>5. Ugroženi potrošači imaju pravo na uslugu snabdevanja u skladu sa ovim članom ako su ispunjeni uslovi iz stava 1. ovog člana, a proverava na svakih šest (6) meseci organ zadužen za socijalnu zaštitu. Ako, zbog promene okolnosti potrošač izgubi status privilegovanog potrošača, isti se briše iz odgovarajuće evidencije, ali podaci ostaju na raspolaganju u periodu od dodatnih pet (5) godina posle od dana upisa u datu evidenciju. Predmetni Operater Sistema Distribucije dužan je da u roku od osam (8) dana, u pisanom obliku obavesti ugroženog potrošača i njegovog snabdevača o brisanju istog iz predmetne evidencije.</p> <p>6. Razliku između troškova i prihoda od delatnosti snabdevača za socijalno ugrožene</p>
--	--	--

<p>konsumatorët e cenueshëm socialë të energjisë elektrike do të mbulohet nga Qeveria.</p> <p>7. Furnizuesi në kuadër të detyrimeve të shërbimit publik është i detyruar të sigurojë kontratë të furnizimit për të gjithë konsumatorët e cenueshëm të energjisë elektrike dhe fillon furnizimin pa vonesë, pasi që konsumatori i cenueshëm të ketë dorëzuar kërkesë të shoqëruar me dëshmi për përmbushjen e kërkesave nga paragrafi 1. të këtij neni.</p> <p>8. Operatorët e sistemit të shpërndarjes do të krijojnë dhe mirëmbajnë një regjistër të konsumatorëve të cenueshëm. Regjistri duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e konsumatorit të cenueshëm, numrin personal të identifikimit, adresën në të cilën ai furnizohet me energji elektrike, numrin nën të cilin ai është i listuar, llojin e trajtimit të veçantë për të cilin ai ka të drejtë dhe përfitimet që i dhurohen me statusin e konsumatorit të cenueshëm. Të dhënat nga regjistri mund t'i prezantohen vetëm konsumatorit të cenueshëm që ka aplikuar për regjistrim në regjistrin përkatës dhe furnizuesit të tij.</p> <p>9. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me konsumatorët e cenueshëm, të përcaktuar në</p>	<p>vulnerable gas customers shall be covered by the Government.</p> <p>7. A supplier under public service obligations shall be obliged to offer a supply contract to all vulnerable electricity customers and shall begin supplying without delay after the vulnerable customer submits a request accompanied with the evidence on meeting requirements from the paragraph 1. of this article.</p> <p>8. The Distribution System Operators shall establish and keep a register of vulnerable customers. The registers shall contain the socially vulnerable customer's first and last name, the vulnerable customer's personal identification number, the address at which he/she is supplied with electricity, the number under which he/she is listed, the type of special treatment to which he/she is entitled and the benefits that are granted to him/her under the status of vulnerable customer. Data from the register may be presented only to the vulnerable customer who has applied for registration into the relevant register and to his/her supplier.</p> <p>9. Rights and obligations linked to vulnerable customers, based on paragraphs 1 and 2 of this</p>	<p>potrošače gasa pokriva Vlada.</p> <p>7. Snabdevač pod obavezom javne usluge dužan je da ponudi ugovor o snabdevanju svakom privilegovanom potrošaču gasa i da počne snabdevanje bez odlaganja nakon što privilegovani potrošač podnese zahtev, zajedno sa dokazom o ispunjenosti uslova iz stava 1. ovog člana.</p> <p>8. Operater Sistema Distribucije dužan je da uspostavi i vodi evidenciju o ugroženim potrošačima. Evidencija sadrži ime i prezime, lični broj, adresu snabdevanja gasom, evidencijski broj ugroženog potrošača, vrstu posebnog postupanja na koje isti ima pravo i beneficije koje su odobrene istom na osnovu statusa ugroženog potrošača. Podaci iz evidencije mogu se pokazati samo ugroženom potrošaču koji se prijavi za upis u odgovarajuću evidenciju, i njegovom snabdevaču.</p> <p>9. Prava i obaveze privilegovanih potrošača, kako je zakonski utvrđeno u stavu 1 i stavu 2</p>
--	--	--

<p>paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, do të zbatohen dhe aplikohen në tërësi nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Në veçanti, operatori i sistemit të shpërndarjes do t'i marrë masat e duhura për t'i mbrojtur konsumatorët fundorë në zonat e largëta të cilët janë të lidhur në sistemin e energjisë elektrike.</p> <p>10. Furnizuesi që ofron furnizim me energji elektrike për konsumatorët e cenueshëm krijon mekanizma për ofrimin e asistencës për konsumatorët e cenueshëm që kanë për qëllim shmangien e shkyçjes si pasojë e faturave të papaguara.</p> <p>11. Bazuar në aktet ligjore në fuqi, masat e duhura si hartimi i planeve kombëtare të energjisë, do të merren në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve sociale për të siguruar furnizimin e nevojshëm me energji elektrike për konsumatorët e cenueshëm, apo sigurimin e mbështetjes për përmirësime të efijencës së energjisë, për trajtimin e varfërisë së energjisë, aty ku ajo identifikohet, duke përfshirë edhe në kontekst më të gjerë të varfërisë. Masat e tilla nuk do pengojnë hapjen efektive të tregut dhe funksionimin e tij, të rregulluar me këtë ligj, dhe të njëjtat njoftohen tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Njoftimet e tilla nuk përfshijnë masat e marra në kuadër të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve sociale.</p>	<p>Article, shall be duly applied and implemented by the Distribution System Operator. In particular, the Distribution system operator shall take appropriate measures to protect final customers in remote areas who are connected to the electricity.</p> <p>10. The supplier offering electricity to vulnerable customers shall set up mechanisms for providing assistance to vulnerable customers aimed at avoiding the disconnection of electricity due to unpaid bills.</p> <p>11. Based on the applicable legal acts, appropriate measures, such as formulating national energy plans, shall be taken in providing social security benefits to ensure the necessary electricity supply to vulnerable customers, or providing for support for energy efficiency improvements, to address energy poverty where identified, including in the broader context of poverty. Such measures shall not impede the effective opening of the market and its functioning, as regulated by this law, and shall be notified to the Energy Community Secretariat. Such notifications shall not include measures taken within the general social security system.</p>	<p>ovog člana, propisno primenjuje i sprovodi operater sistema distribucije. Posebno, operater sistema distribucije je dužan da preduzme odgovarajuće mere za zaštitu krajnjih potrošača u udaljenim sredinama, a koji su priključeni na sistem prirodnog gasa.</p> <p>10. Snabdevač koji nudi snabdevanje privilegovanih potrošača gasom dužan je da uspostavi mehanizme za pružanje pomoći privilegovanim potrošačima, u cilju izbegavanja isključenja prirodnog gasa zbog neplaćenih računa.</p> <p>11. Na osnovu važećih zakonskih akta, preduzimaju se odgovarajuće mere, kao što je izrada nacionalnih planova za energetiku, kako bi se obezbedila socijalna davanja u cilju obezbeđivanja neophodne snabdevenosti privilegovanih potrošača gasom, ili u cilju obezbeđivanja podrške za unapređenje energetske efikasnosti, kako bi se rešila nestašica energije tamo gde je potrebno, uključujući u širem kontekstu siromaštva. Takve mere ne smeju da naruše delotvorno otvaranje tržišta i njegovo funkcionisanje, kako je uređeno ovim Zakonom, i o istima se obaveštava Sekretarijat Energetske Zajednice. Takvo obaveštenje ne sadrži mere preduzete u okviru opšteg sistema socijalne zaštite.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 47 Obligimi i kyçjes së konsumatorit dhe prodhuesit</p>	<p align="center">Article 47 Obligation to connect customers and producers</p>	<p align="center">Član 47 Obaveza priključenja potrošača i proizvođača</p>
<p>1. Operatorët e sistemeve duhet të mundësojnë kyçjen në sistem të çdo konsumatori apo prodhuesi:</p> <p>2. Pala që kërkon kyçjen duhet t'i përmbahet obligimeve:</p> <p>2.1. posedimi i pajisjeve ndërprerëse elektrike të instaluar brenda kufijve të pronës së tij e cila i përmbush kërkesat teknike dhe operacionale të sigurisë;</p> <p>2.2. plotësimi i kushteve për kyçje në sistemin e transimit apo shpërndarjes, përfshirë Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Shpërndarjes, sipas kërkesës;</p> <p>2.3. nënshkrimi i marrëveshjes me shkrim me operatorin ku kërkon të kyçet përkitazi me kyçjen, duke përfshirë pagesën e rregulluar për kyçje dhe pagesën për shfrytëzim të sistemit, sipas nevojës;</p> <p>2.4. pagimi i të gjitha borxheve të paguara të marrëveshjes për kyçje; dhe</p> <p>2.5. kur pala është konsumator, ofrimi i dëshmive të kënaqshme se ekziston</p>	<p>1. System operators shall provide connection to the system of all customers or producers;</p> <p>2. The party requesting connection shall adhere to certain obligations:</p> <p>2.1. having electrical switchgear equipment installed within the boundaries of its property which satisfy the technical and operational safety requirements;</p> <p>2.2. meeting the conditions for connection to the transmission or distribution system, including the Grid Code and Distribution Code as applicable;</p> <p>2.3. having signed a written agreement with the operator with which it wishes to connect, in respect of the connection, including the regulated connection charge, and the use of system charge where applicable;</p> <p>2.4. having paid all amounts due in the agreement for the connection; and</p> <p>2.5. where the party is a customer, providing satisfactory evidence that a</p>	<p>1. Operateri Sistema treba da omogućavaju prikljućenje u sistem svakom potrošaču ili proizvođaču.</p> <p>2. Stranka koja traži prikljućenje treba da se pridržava obavezama:</p> <p>2.1. posedovanje električne opreme isključivanja ugrađenih unutar granica njegove svojine, koja ispunjava tehničke i operacione uslove sigurnosti;</p> <p>2.2. ispunjavanje uslova za prikljućenje u prenosni ili distributivni sistem, uključujući Kodeks mreže i Kodeks Distribucije, prema zahtevu;</p> <p>2.3. potpisivanje pismenog sporazuma sa operatorem gde traži da se priključuje, u vezi sa priključenjem, uključujući predviđeno plaćanje za prikljućenje i plaćanje za korišćenje sistema, prema potrebi;</p> <p>2.4. plaćanje svih neisplaćenih dugova sporazuma za prikljućenje; i</p> <p>2.5. kada je stranka potrošač, pružanje zadovoljavajućih dokaza da postoji</p>

<p>kontrata e lidhur me furnizuesin për furnizimin me energji përmes kyçjes duke përfshirë përgjegjësinë e balancimit.</p> <p>3. Kushtet dhe afatet për kyçje në sistemin e shpërndarjes apo të transmisionit duhet të bazohen në procedura efikase, transparente dhe jodiskriminuese për kyçje, të përcaktuara në Kodin e Rrjetit apo Kodin e Shpërndarjes metodologjitë përkatëse për kyçje që miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe që publikohen nga operatorët përkatës.</p>	<p>contract exists with a supplier for the supply of energy through the connection, including balance responsibility.</p> <p>3. The terms and conditions for the connection to the transmission or distribution systems shall be transparent and efficient procedures for non-discriminatory connection, provided in the published Grid Code or Distribution Code as well as with relevant connection methodologies and approved by the Energy Regulatory Office.</p>	<p>zaključeni ugovor sa snabdevačem za snabdevanje električne energije kroz priključenje, uključujući odgovornost balansiranja.</p> <p>3. Uslovi i rokovi za priključenje u distributivni ili prenosni sistem mora da se baziraju u efikasne, transparentne i nediskriminatorne procedure za priključenje, utvrđene u Kodeksu Mreže ili Kodeksu Distribucije odgovarajuće metodologije za priključenje, koje se usvajaju od strane Regulatorne Kancelarije za Energiju i objavljuju od odgovarajućih operatera.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 48 Refuzimi i kyçjes në sistem</p>	<p style="text-align: center;">Article 48 Refusal of System Connection</p>	<p style="text-align: center;">Član 48 Odbijanje priključenja u sistem</p>
<p>1. Operatori i Sistemit të Transmisionit nuk ka të drejtë të refuzojë kyçjen e një centrali të ri për arsye të kufizimeve të mundshme të kapaciteteve të rrjetit në dispozicion, siç mund të jetë kongjestioni në pjesët më të largëta të sistemit të transmisionit. Operatori i Sistemit të Transmisionit duhet të sigurojë informatat e domosdoshme për palën e interesuar .</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmisionit nuk do të ketë të drejtë të refuzojë ndonjë pikë të re të kyçjes për arsye se kjo do të rezultonte me shpenzime shtesë që ndërliken me ngritjen e domosdoshme të kapaciteteve të</p>	<p>1. The Transmission System Operator shall not be entitled to refuse the connection of a new power plant on the grounds of possible future limitations to available network capacities, such as congestion in distant parts of the transmission system. The Transmission System Operator shall supply necessary information for interested party.</p> <p>2. The Transmission System Operator shall not be entitled to refuse a new connection point, on the ground that it will lead to additional costs linked with necessary capacity increase of system elements in the close-up range to the</p>	<p>1. Operater Prenosnog Sistema nema pravo da odbija priključenje nove centrale iz razloga mogućih ograničenja kapaciteta raspoložive mreže, kao što može biti konekcija u naj udaljenim delovima prenosnog sistema. Operater Prenosnog Sistema treba da osigurava neophodne informacije za zainteresanu stranu.</p> <p>2. Operater Prenosnog Sistema nema pravo da odbija neku novu tačku priključenja, iz razloga da bi to rezultiralo dodatnim troškovima, koji se nadovezuju sa neophodnom izgradnjom kapaciteta</p>

